# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-453193**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Çoi padashje një video në grupin e shoqeve, si u zbulua abuz*mi i vajzës në Tiranë nga djali i hallës dhe tezja |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/oi-padashje-nje-video-ne-grupin-e-shoqeve-si-u-zbulua-i-i-12-vj-i104715` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 18:24:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 18:12:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | 7b5e19ee6c992f3dfc1ac71b2b427ee4bdb2b4550b7a71e365b8a394ad0da736 |
| TEKSTI | 451f3a49018b9a6704e6e83c474fc3499b95a7d2a4e8f1b1588184d3b8b4e5ba |
| PAMJA | 107b366313a63ba4a572430af172c778d0346fe9c880376c6be35f85d03fb46c |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | d07ab56b16492a9f0c67e6fa9f416568e6b217bcd30b7d12ae0ddee9829e7701 |
| E MËPARSHMJA | e71f0ecc8379c36b630f6c494292f3e4448239d169af8d98cf845fef106800e3 |
| RRËNJA MERKLE | 902d0413a229cd6f0d4d0cd18f47f680be9b1c51dede64b7e44b0e89ca82109d |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d07ab56b16492a9f0c67e6fa9f416568e6b217bcd30b7d12ae0ddee9829e7701`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Çoi padashje një video në grupin e shoqeve, si u zbulua abuz*mi i vajzës në Tiranë nga djali i hallës dhe tezja

Piranjat Përditësimi i fundit 17 Shtator 2026, 20:12



Një ngjarje e tmerrshme është bërë publike ditën e sotme, 17 shtator, ku është mësuar se një 12-vjeçare, dyshohet se është abuzuar seksualisht nga djali i hallës dhe tezja e saj. Të dy personat janë arrestuar nga Policia e Tiranës, nën dyshimet për veprat penale "Marrëdhënie seksuale me të mitur", "Incest" dhe "Pornografi".

Gazetarja Glidona Daci, pohoi se ndodhej pranë Drejtorisë së Policisë së Tiranës, në përpjekje për të siguruar më shumë informacione, megjithatë, për shkak të ruajtjes së anonimatit të të miturës dhe sensitivitetit të çështjes, autoritetet janë treguar të rezervuara në dhënien e detajeve.

*"Sipas informacioneve që ne kemi, padashur, 12-vjeçarja ka hedhur një nga materialet që dyshohet se ka pasur pamje pornografike në një nga grupet e chat-it që ajo kishte me shoqet e saj. Nga frika se kjo pamje filmike mund të shpërndahej te persona të tjerë, ajo ka kontaktuar fillimisht psikologen e shkollës, e cila, menjëherë e alarmuar, ka lajmëruar zyshën kujdestare e më pas prindërit e vajzës, po ashtu edhe strukturat e policisë."*

Gazetarja u shpreh se menjëherë pas sinjalizimit, strukturat e rendit kanë bërë të mundur shoqërimin e vajzës në ambientet e policisë, në prani të prindërve dhe psikologes. Aty është bërë edhe marrja në pyetje e saj, për orë të gjata, me asistencën e psikologes.

*"Është bërë e mundur marrja në pyetje me anë të psikologes, ku kanë zbuluar më pas informacione që i kanë tronditur edhe vetë hetuesit. Të gjithë ata që janë marrë me rastin janë në gjendje shumë të shokuar nga ajo se çfarë kanë arritur të shohin. Fillimisht, hetuesit, nga ajo çfarë kanë gjetur, kanë rënë në gjurmët e djalit të hallës së saj, i cili është në moshën 29-vjeçare. Identiteti i tij nuk është bërë i ditur, për shkak se mund të çojë në identifikimin e vajzës."*

Gjatë hetimeve, autoritetet dyshohet se kanë zbuluar edhe materiale të tjera pornografike, duke ngritur dyshime për përfshirjen e tezes së 12-vjeçares. Për këtë arsye, sipas gazetares, është bërë i mundur edhe shoqërimi dhe arrestimi i saj.

Sipas Dacit, ngjarja dyshohet të ketë nisur rreth tre muaj më parë. Nga informacionet e deritanishme, nuk dyshohet se dy personat e përfshirë kanë pasur lidhje mes tyre në aktin e rëndë të ndërmarrë ndaj vajzës së mitur.

*"Çështja është ende nën hetim dhe ndoshta nga verifikimet e mëtejshme dhe ekspertiza e detajuar e telefonave të të dyshuarve mund të dalin dhe të dhëna që mund të provojnë ndoshta edhe një marrëdhënie tjetër, atë të 29 vjeçarit dhe 32 vjeçares."*

Ajo bëri gjithashtu të ditur se abuzimet kanë ndodhur në kohë të ndryshme dhe vende të ndryshme.


## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 17 Shtator19:54

**Me 200 km/orë në Audi RS8 për të dërguar 50 mln euro kokainë. Si u godit banda e rrezikshme shqiptare**

Policia spanjolle ka goditur një organizatë kriminale shqiptare të rrezikshme, e cila e kishte qendrën në Katalonja. Gjatë kë...

AKTUALITET 17 Shtator19:52

[“Populli pa bukë, Belinda me vila”, pankartat e protestës së 110-të]

Pankartat e protestës së 110-të kundër qeverisë kanë përcjellë mesazhe të drejtpërdrejta ndaj kryeministrit Ed...

AKTUALITET 17 Shtator19:04

[Falsifikoi 1143 hektarë në Fier/ Prokuroria jep urdhër për arrestimin e Kastriot Haskos, detaje nga dosja]

Me kërkesë të Prokurorisë së Fierit, është vënë në pranga sot Kastriot Hasko, i akuzuar si përfituesi i p...

AKTUALITET 17 Shtator18:58

[SPAK nis hetimet për pagat e magjistratëve, sekuestron praktikat te Ministria e Financave]

SPAK ka nisur hetimet për çështjet e pagave të gjyqtarëve. Prokuroria e Posaçme ka sekuestruar praktikat te Financat. Drejtue...

AKTUALITET 17 Shtator18:41

[Zbardhet vendimi i plotë i gjykatës, si u zbulua vila e dytë e Ballukut]

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur sekuestrimin preventiv të një vile në kompleksin &ldq...

AKTUALITET 17 Shtator17:37

[“Revolucioni i Flamingove” nuk ndalet, përplasje me policinë dhe shoqërime]

Protestuesit nisën të mblidheshin rreth orës 10:00 pranë godinës së Kuvendit, pak përpara fillimit të seancës plena...

AKTUALITET 17 Shtator17:29

[Shkodër/ Bypass pa ndriçim natën, banorët: Kalimi i rrugës i rrezikshëm]

Sistemi i ndriçimit në Bypass-in e Shkodrës ndodhet në gjendje degradimi prej kohësh, duke lënë pjesën më të...

AKTUALITET 17 Shtator17:10

[Aeroporti i Vlorës/ MIE: Arbitrazhi i Emergjencës rrëzon kërkesat kryesore të VIA-s! Nuk pranon të pezullojë zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit]

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka bërë me dije se Arbitrazhi i Emergjencës ka rrëzuar kërkesat kryesore t&eum...

AKTUALITET 17 Shtator16:28

[Velipojë/ Pësoi arrest kardiak pasi u fut në det, humb jetën pushuesi nga Kosova]

Një i moshuar nga Kosova ka humbur jetën sot në plazhin e Velipojës. Policia bën me dije rreth orës 15:30, në zonën e &...

AKTUALITET 17 Shtator16:25

[Daja i deputetes së PS e rrahu dhe i plagosi me drapër të atin, 34-vjeçarja sqaron foton e publikuar nga Zegjine Çaushit: Ja si qëndron e vërteta]

Sot u mbajt seanca për Bledar Bakajn, dajën e deputetes së PS-së, Zegjine Çaushit, ku u vendos masa e sigurisë “Arrest me ...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 16 Shtator

[Sarandë, tre persona plagosen me thikë pranë sh...]

Një ngjarje e rëndë është shënuar mbrëmjen e sotme në Sarandë, ku tre persona kanë mbetur të plagosur me ...

BOTA 16 Shtator

[VIDEO- Dy aksidente me pesë viktima/ Prezantues...]

Pesë persona kanë humbur jetën në një aksident të dyfishtë tragjik në Los Anxhelos, ndërsa një gazetare televi...

LIFESTYLE 16 Shtator

[Prishtinë/ Shqiptarët protestojnë kundër vendim...]

Ndërkohë që në rrugët e Prishtinës po zhvillohen protesta e tubime lidhur me vendimin e Gjykatës Speciale të Hagës ...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

[Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues]

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

### video



### E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.